



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË

**RAPORT**

**PËR REZULTATET E KONSULTIMIT PUBLIK PËR**

**PROJEKTLIGJIN:**

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 54/2024 “PËR KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

**1. Titulli i draft aktit/dokumentit**

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ka për qëllim të realizojë disa ndryshime në përmbajtjen e neneve të ligjit nr. 54/2024 që lidhen me rregullimin e roaming dhe përfshirjen në legjislacionit shqiptar të acquis të roaming.

Hartimi i këtij projektligji, vjen si një nevojë në procesin e integritit të përshtetur në tregun digjital të BE-së, për zbatimin e Roaming Like At Home me BE-në dhe përafrimin e acquis të roaming, të identifikuar nga Bashkimi Evropian si të nevojshme për realizimin e RLAH me BE.

Realizimi i RLAH do të sillte përfitime për lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe përmirësonte klimën e biznesit midis Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të Bashkimit Evropian dhe do ishte një hap i rëndësishëm drejt integritit në tregun unik digjital të BE-së.

**2. Kohëzgjatja e konsultimeve**

*Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse*

*kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.*

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, është propozim i Ministrit për Infrastrukturën dhe Energjinë, si ministër përgjegjës për telekomunikacionin, rrjetet e komunikimeve elektronike dhe ka për qëllim të miratojë disa ndryshime në përmbajtjen e neneve të ligjit nr. 54/2024 që lidhen me rregullimin e roaming dhe përfshirjen në legjislacionit shqiptar të acquis të roaming.

Ky projektligj është publikuar në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (në nivel eksperti dhe qytetari) në datë 28 dhjetor 2025 deri në 27 Janar 2026, për një periudhë 20 ditë pune, në respektim të afatit ligjor të konsultimit.

### **3. Metoda e konsultimit**

*Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.). Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitetet nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).*

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ishin:

Projektligji i’u nënshtua **konsultimit paraprak** gjatë vitit 2025, përmes:

1. Disa takime me grupet e interesit, me AKEP dhe dy operatorët e telefonisë së lëvizshme Vodafone Albania dhe One Albania si më poshtë:
  - Takimi i parë në datë 22.7.2025. Në këtë takim operatorët u informuan për iniciativën për RLAH me BE si dhe u kërkua informacion mbi shërbimet e romaingut, trafikun e roamingut midis Shqipërisë dhe vendeve të BE, po ashtu dhe me Ballkanin Perëndimor;
  - Një takim i dytë i nivelit të lartë, u zhvillua me datë 28 Tetor 2025, me drejtuesit ekzekutive të operatorëve të telefonisë së lëvizshme në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe AKEP.
  - Takime të nivelit teknik me përfaqësues të AKEP dhe operatorëve;

2. Workshopi rajonal i TAIEX i organizuar nga Komisioni Evropian në 18 - 19 tetor 2025, për zbatimin e “Roaming Like at Home” midis BE dhe vendet e Ballkanit Perëndimor ku u shpjeguan kërkesat e acquis të BE për roaming që duhen reflektuar në legjislacionin kombëtar;

Gjatë vitit 2026, konsultimi u krye nëpërmjet metodave si më poshtë:

1. Nëpërmjet publikimit në Regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike nga data 28 dhjetor 2025 deri në 27 Janar 2026, të projektligjit dhe paketës shoqëruese;
2. Nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në datë 28 dhjetor 2025 deri në 27 Janar 2026, të projektligjit dhe paketës shoqëruese;
3. Ndërmjet postës elektronike të koordinatorit për njoftim dhe konsultim publik: [vilma.davidhi@infrastruktura.gov.al](mailto:vilma.davidhi@infrastruktura.gov.al);

#### **4. Palët e interesit të përfshira**

*Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit. Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese. Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e Aktit.*

Hartimi i projektligjit është bërë nga stafi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

2 (dy) operatorë të komunikimeve elektronike, të telefonisë së lëvizshme: One Albania dhe Vodafone Albania ishin palët e interesit që u përfshin në këtë proces konsultimi.

#### **5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara**

*Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën; Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato; Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.*

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ka pasur 640 lexime nga qytetarët dhe 490 lexime nga ekspertë. Gjatë publikimit në regjistrin elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik nuk ka pasur komente apo sugjerime të paraqitura.

Gjatë procesit paraprak të konsultimeve si dhe lidhur me projektligjin kanë sjellë mendim në rrugë elektronike 2 (dy) operatorë të komunikimeve elektronike të telefonisë së lëvizshme: One Albania dhe Vodafone Albania.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Efekti financiar negativ që pritet të ketë tek operatorët celularë  Koha e nevojshme për zbatim përshtatjen e sistemeve, rishikimin e marrëveshjeve të roamingut etj	Operatorët shprehen në mbështetje të procesin e integritit dhe RLAH dhe sjellin në vëmendje kohën e nevojshme për zbatim dhe efektet financiare ne uljen e të ardhurave te operatorëve. Lidhur me efektet financiare nga ulja e tarifave për	One Albania dhe Vodafone Albania	Pranuar/pjesërisht	Zbatimi i RLAH me BE do të shënojë një hap të rëndësishëm në integrimin në tregun e përbashkët Evropian në fushën digjitale si pjesë e rëndësishme e procesit të integritit në BE dhe tregun e vetëm digjital (DSM).

	<p>shkak të zbatimit të tarifës së unifikuar për terminimin e thirrjeve të lidhura me zbatimin e RLAH me BE, sqarojmë se zbatimi i RLAH me BE do të shënojë një hap të rëndësishëm në integrimin në tregun e përbashkët Evropian në fushën digjitale si pjesë e rëndësishme e procesit të integritimit në BE.</p>		<p>Zbatimi i Roaming Like at Home (RLAH) me BE është me interes të lartë publik me efekte pozitive për përdoruesit. Zbatimi i rregullimit do ketë impakt në uljen e të ardhurave të operatorëve që pritet të zbutet nga rritja e volumit të trafikut dhe zbatimi reciprok i RLAH. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me AKEP, me qëllim informimi dhe planifikimi në kohë nga ana e operatorëve, zhvilloi takimin e parë informues me përfaqësuesit e nivelit të lartë të operatorëve celulare me</p>
--	---	--	---

				<p>datë 22.7.2025.</p> <p>Një takim i dytë i nivelit të lartë me drejtuesit ekzekutive të operatorëve celularë është zhvilluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me datë 28 Tetor 2025.</p>
Sugjerime për formulimet e neneve të ligjit.	Sugjerime për formulimet e neneve të ligjit.	One Albania	Pranuar, pjesërisht	<p>Komisioni Evropian kërkon harmonizim të plotë i acquis për roaming dhe në projektligj është ruajtur në mënyrë rigorozë formulimi sipas neneve të acquis.</p>